



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:213189

Datë: 28.02.2025

Numri i dokumentit: 06923659

P.nr.14/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË P. – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjyquese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale kundër të pandehurit Personit Juridik Elkos SH.P.K, me seli në P., për shkak të veprës penale “*Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë*” nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarit personit përgjegjës të personit juridik Argjend Husaj, nga Peja, për shkak të veprës penale “*Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë*” nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në P. – Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë PP/II.nr.600/2022 të datës 04.11.2024, e plotësuar me datë 14.01.2025, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike të shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë më datën 28.01.2025, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj, nga Prokuroria Themelore në P., përfaqësueses së autorizuar të personit juridik Elkos SH.P.K., A. A., të pandehurit Argjend Husaj, mbrojtësit të të pandehurit av.Agron Galani, nga Peja, sipas autorizimit, me datën 30.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 28.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. **PERSONI JURIDIK “ELKOS” SH.P.K** (Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar), me seli në P., rr. “Z. P.”, p.n., në P., me pronar Ramiz Kelmendi, me numër unik identifikues, numër të biznesit, numër të njësisë-me veprimtari primare Industria e përpunimit të mishit P.-Zahaq, me përfaqësuese të autorizuar **A. A.**,
2. **PERSONI PËRGJEGJËS I PERSONIT JURIDIK: ARGJEND HUSAJ**, i lindur më datë, në P., nga i ati B. dhe nëna C., e vajzërisë K., me vendbanim në rr. “A. H.”, nr..., në P., me profesion, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, posedon numër telefoni, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**,

JANË FAJTOR

Për shkak se:

I pandehuri: Personi juridik “ELKOS” SH.P.K.,

- I.** Me datën, rreth orës 10:15, në fshatin Z., Komuna P., pikërisht në fabrikën për përpunimin e mishit “.....” dhe të Depos se mishit në kuadër të “Elkos” sh.p.k, në depon qendrore të përpunimit të mishit ofron për shitje dhe vë në qarkullim artikuj ushqimor për të cilat e di se janë të dëmshme për shëndetin e njerëzve në atë mënyrë që, në kuadër të veprimtarisë afariste bën prodhimin dhe shitjen e mishit nën kushtet jo të duhura higjiëno-teknike, mishi dhe produktet e tjera me afat të skaduar të cilat nuk i plotësonin kushtet për konsum njerëzor janë gjetur në të njëjtin frigorifer me produktet e tjera me afat dhe të gatshme për plasim në treg, të cilat më pas me rekomandim të inspektorëve të AUV-it, janë asgjësuar, në total 35289 kg mish dhe produkte tjera me afat të skaduar.
- Me këtë ka kryer veprën penale **“Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë”** nga neni 261 par.1 të KPRK-së.

I pandehuri: Personi përgjegjës i personit juridik: Argjend Husaj,

- II.** Me datën, rreth orës 10:15, në fshatin Z., Komuna P., pikërisht në fabrikën për përpunimin e mishit “.....” dhe të Depos se mishit në kuadër të “Elkos” sh.p.k këtu i pandehuri Argjend Husaj, në pozitën menaxher i depos së përpunimit të mishit dhe atë si person përgjegjës i personit juridik “Elkos” sh.p.k, ofron për shitje dhe vë në qarkullim artikuj ushqimor për të cilat e di se janë të dëmshme për shëndetin e njerëzve në atë mënyrë që, në kohën dhe vendin e lartcekur, pas një kontrole nga ana e policisë dhe Inspektorëve të AUV-it, tek subjekti i lartcekur është konstatuar se zhvillohet veprimtari e prodhimit dhe shitjes së mishit nën kushtet jo të duhura higjiëno-teknike, mishi dhe produktet e tjera me afat të skaduar të cilat nuk i plotësonin kushtet për konsum njerëzor janë gjetur në të njëjtin frigorifer me produktet e tjera me afat dhe të gatshme për plasim në treg, të cilat më pas janë asgjësuar nga Inspektorët e AUV-it, dhe atë sasia e përgjithshme 35289 kg, mish dhe produkte tjera me afat të skaduar.
- Me këtë ka kryer veprën penale **“Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë”** nga neni 261 par.1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8, 17, 21, 38, 39, 43, 44, 44 par.1, 69 par.1 pika 3.6 dhe 3.7, 70, 112, 261 par.1 të KPRK-së, nenit 9 të ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale si dhe nenit 358, 364, 449, 450, 452, të KPPRK-së:

I PËRCAKTON

Të pandehurin:

I. Personin juridik “Elkos” SH.P.K”,

-Për veprën penale “*Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë*” nga neni 261 par.1 të KPRK-së, nga dispozitivi i parë (I) i këtij aktgjykimi, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË, në shumë prej dhjetë mijë (10.000) euro, të cilën shumë i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurin:

II. Argjend Husaj, si person përgjegjës i personit juridik:

- Për veprën penale “*Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë*” nga neni 261 par.1 të KPRK-së, nga dispozitivi i dytë (II) i këtij aktgjykimi i përcakton:

Me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim me nenin 44 par.1 të KPRK-së, **ZËVËNDËSOHET** në dënim me gjobë në shumën prej tremijë (3000) euro, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe:

Me **DËNIM MË GJOBË**, në shumën prej katërmijë (4000) euro, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform dispozitës së nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së, pas unifikimit të dënimit më gjobë për të akuzuarin Argjend Husaj, gjykata:

I GJYKON

- I. **Të akuzuarin, personin juridik “Elkos” SH.P.K”, me DËNIM ME GJOBË** në shumën prej dhjetëmijë (10.000) euro, të cilën shumë i pandehuri obligohet ta paguaj në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë.
- II. **Të akuzuarin Argjend Husaj, me DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumën prej shtatëmijë (7000) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse i pandehuri Argjend Husaj, dënimin e shqiptuar në të holla dështon, refuzon apo nuk mund të paguaj, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par. 3 të

KPRK-së, do t'ia zëvendësojë me dënim me burgim, ku një (1) ditë burgimi do ti llogaritet me njëzetë (20) euro gjobë.

- IV. Obligohen të pandehurit secili veç e veç, që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Arsvetim

Prokuroria Themelore në P.-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.600/22 të datës 04.01.2024, kundër të pandehurit person juridik Elkos SH.P.K, për shkak të veprës penale “*Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë*” nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-së si dhe ndaj personit përgjegjës të personit juridik të pandehurit Argjend Husaj nga Peja, për shkak të veprës penale “*Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë*” nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-së, të cilës aktakuzë i është bashkangjitur edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë me numër PP/II.nr.600/22 e datës 14.01.2025, e arritur ndërmjet Kryeprokurorit dhe prokurorit të shtetit të kësaj prokurorie, në njërën anë dhe përfaqësueses së autorizuar e personit juridik Elkos Group SH.P.K A. A., të pandehurit Argjend Husaj, mbrojtësit të pandehurit av.Agron Galani nga Peja, në anën tjetër.

Gjykata me datë 28.01.2025, për këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore lidhur me shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në P., përfaqësuesja e autorizuar e personit juridik Elkos Group SH.P.K A. A., të pandehurit Argjend Husaj si dhe mbrojtësit të pandehurit Av.Agron Galani nga Peja, sipas autorizimit.

Gjykata në këtë seancë ka shqyrtuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, me ç'rast pas dëgjimit të palëve, lidhur me marrëveshjen për pranim të fajësisë, është konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë sipas marrëveshjes, si dhe marrëveshja është bërë në baza vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshëm me mbrojtësin dhe përfaqësuesin e tyre, dhe i pandehuri personi juridik “Elkos” dhe i pandehuri-personi përgjegjës Argjend Husaj, nuk kanë qenë të shtrënguar apo të detyruar në lidhjen e marrëveshjes, pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat që i janë bashkëngjitur aktakuzës, si dhe nuk ekziston asnjëra nga rrethanat për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale të parapara me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe është e bazuar në nenin 233 par.21 të KPRK-së dhe gjykata ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i pandehuri personi juridik “Elkos” dhe i pandehuri-personi përgjegjës, i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, dhe se një marrëveshje e tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarve, e cila po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Shënim zyrtar nga DHKEK, zyrtarët policor I. Sh.#..... dhe F. Sh.#....., të datës 16.03.2022; Procesverbal i Inspektorëve të AUV-it, me numër 0002798, datës 15.03.2022; Procesverbali Inspektorëve të AUV-it, me numër 0002800, datës 15.03.2022; Urdhër për zbrazje nga KRM “Ambienti” me numër 42/30, datës 01.03.2022; Shkresa zyrtare e AUV-it, me numër 464/22, datës 18.03.2022; mEvidenca e mallit të skaduar pranuar nga zyrtarja R. G. R.; Kopja e shkresës së komunikimit me furnitorin për mallin e dëmtuar 173 pako; Kërkesa drejtuar AUV-it dhe përgjigja e pranuar, procesverbale, raporte, rezultate të analizave, kërkesa për asgjësim të produkteve, fotografi të asgjësimit; Kërkesa drejtuar “Elkos” SH.P.K datës 07.04.2022; Foto nga vendi i ngjarjes; Deklarata e të pandehurit Argjend Husaj, e dhënë në stacionin policor në P. me datë 15.03.2022, si dhe në Prokurorinë Themelore në P. me datë 06.03.2023; nDeklarata e të pandehurit Arjanit Avdyli e dhënë në Stacionin Policor në P. me datë 15.03.2022, si dhe në Prokurorinë Themelore në P. me datë 06.03.2023; Deklarata e përfaqësuesit të autorizuar të personit juridik “Elkos” SH.P.K, e dhënë në Prokurorinë Themelore në P. me datë 10.11.2023. Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 233 par.21 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit personi juridik “Elkos” SH.P.K dhe të pandehuri-personit përgjegjës Argjend Husaj.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave rënduese dhe lehtësuese, lidhur me shqiptimin e dënimit ndaj të pandehurve, si në pikën 1 dhe 3 të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, konsideroj se propozimet e tilla tani janë konsumuar me rastin e propozimit të kufijve të minimumit dhe maksimumit të dënimeve në këto pika, ndërsa sa i përket shqimit të dënimit, përkatësisht zëvendësimit të dëmit me burgim, ne dëmin me gjobë, për të pandehurin Argjend Husaj, sipas pikës 2 të marrëveshjes, i propozoj gjykatës që të merr parasysh dënimet e eventuale mëparshme të të pandehurit, ndërsa rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri qysh në procedurën paraprake ka lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë për ketë vepër.*

Përfaqësuesja e autorizuar e personit juridik “Elkos” SH.P.K, A. A., ka deklaruar se: *si rrethanë lehtësuese konsideroj që duhet të mirët pranimi i fajësisë, ndërsa sa i përket lartësisë së gjobës, për këtë çështje do të vendos gjykata.*

Mbrojtësi i të pandehurit Argjend Husaj, av.Agron Galani, ka deklaruar se: *sa i përket rrethana lehtësuese, gjykata të këtë parasysh sjelljen korrekte dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale, pendimin e tij për veprën e kryer, faktin se i*

njëjti është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin dhe atë jo drejtpërdrejtë, por si mbikëqyrës, për çka i propozoj gjykatës që me rastin e vlerësimit të vendimit mbi lartësinë e dënimit sa i përket pikës 3 të kësaj marrëveshje, të caktoj minimumin e caktuar, ndërsa sa i përket pikës 2, zëvendësimin të dënimit me burg në dënim me gjobë, me pëlqimin e të pandehurit konfirmon nenin 44, të shqiptohet një dënim sa më i ultë, duke pasqyruar se do të shqiptohen 2 dënime me gjobë, dhe të ardhurat e tija mesatare mujore, do të ndikohet ekonomia familjare.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu mosmarrëveshjen e pranimit të fajësisë është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit personit juridik Elkos SH.P.K., janë formuar elementet e veprës penale “*Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë*” nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-së, si dhe ndaj personit përgjegjës të personit juridik të pandehurit Argjend Husaj, nga Peja, janë formuar elementet e veprës penale “*Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë*” nga neni 261 paragrafi 1 i KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek i pandehuri personi juridik Elkos SH.P.K konform nenin 112 të KPRK-së, si dhe tek i pandehuri Argjend Husaj, ka ekzistuar dashja që vepra penale të kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që të njëjtit kanë qenë të vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e kanë dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurve kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë të pandehurit janë të vetëdijshëm për veprën e kryer penale dhe gjykata e ka vërtetuar se e kanë kryer me dashje.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu në raport me të pandehurin person juridik Elkos SH.P.K., si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit personit juridik, për veprën penale që i vihet në barrë, shprehjen e keqardhjes, ndërkaq rrethana rënduese përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale, në mënyrën, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, rrethana rënduese përtej elementeve përbërëse të figurës së veprës penale në rastin konkret nuk gjeti.

Ndërsa, në raport me personit përgjegjës të personit juridik: Argjend Husaj, si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, faktin se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, ndërkaq rrethana rënduese përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale, në mënyrën, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, rrethana rënduese përtej elementeve përbërëse të figurës së veprës penale në rastin konkret nuk gjeti.

Prandaj, rrethana të lartcekura kanë ndikuar që gjykata ta aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe të pandehurve të i'a shqiptoi dënimin e propozuar brenda kufijve të marrëveshjes

së arritur për pranimin e fajësisë, dhe atë dënimet e precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

Gjykata ka shqiptuar dënimin sikur në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit, konform neni 9 par.1 të Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik¹, i cili përcakton se: *“Për veprat penale të personave juridik dënimi i paraparë me gjobë nuk mund të jetë më i vogël se njëmijë (1.000) Euro dhe më i lartë se njëqindmijë (100.000) Euro”,* ndërkaq paragrafi 2 nën par.2.2 i këtij neni përcakton se: *“2. Dënimi me gjobë shqiptohet në shumat si vijon: 2.2. për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim nga tri (3) deri në tetë (8) vite, Gjykata mund të shqiptoj dënim me gjobë, nga pesëmijë (5.000) gjerë në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro”,* andaj në përputhje me nenin 261 par.1 të KPRK-së, në të cilën përcaktohet dënueshmëria e veprës penale Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë, ligjvënësi ka paraparë *“1. Kushdo që prodhon me qëllim të shitjes, shet, ofron për shitje apo në ndonjë mënyrë tjetër vë në qarkullim artikuj ushqimorë, pije apo produkte të tjera për të cilat kryesi e di se janë të dëmshme për shëndetin e njerëzve, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në katër (4) vjet.”*

Gjykata duke u bazuar në të gjitha të sipërhënuarat, gjykata fillimisht të personi përgjegjës i personit juridik Argjend Husaj, i shqiptoi dënimet për veprën penale për të cilat akuzohet, pastaj në kuptim të dispozitave ligjore të neni 76 par. 1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së, pas unifikimit të dënimit me gjobë të njëjtit i ka shqiptuar dënimin unik me gjobë si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi të cilën i njëjti obligohet ta paguaj brenda periudhës së përcaktuar kohore si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi nëse i pandehuri dështon, refuzon apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin e shqiptuar me gjobë është marrë konform neni 43 par. 3 të KPRK-së.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të neni 453 par. 1 të KPP-së, e ngarkoi të pandehurin me shpenzimet e procedurës dhe e obligoi që konform neni 450 par. 2 nënpar. 2.6 të KPPRK-së, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) euro, e po ashtu konform neni 39 par. 3 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neni 364 dhe 365 të KPPRK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË P.

¹ Ligji Nr. 04/L-030 Për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale. <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2766>

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.14/24, me datë 28.02.2025.

Bashkëpunëtorë profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Leonita Lajçi Muçaj

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.